



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:132375

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05531264

P.nr.305/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, gjyqtari i vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me bashkëpunëtorja profesionale Gentiana Dakaj, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurve A. K. dhe S. K. që të dy nga fsh. M. K. L., të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.2731/23 të datës 23.05.2023, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në bazë të nenit 229 par.1 dhe 5 të KPPK-së, jashtë seancës gjyqësore, me datën 02.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr..../24, e datës 21.03.2024, e lidhur në mes të pandehurve A. K. dhe S. K. që të dy nga fsh. M. K. L. dhe të dëmtuarit A. K. nga fsh. M. K. Lipjan, e lidhur në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan.

II.HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.2731/23 të datës 23.05.2023.

III.PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurve A. K. dhe S. K. që të dy nga fsh. M. K. L., shqiptar, shtetas të Republikës së Kosovës, për shkak se të njëjtit kanë arritur marrëveshje të ndërmjetësuar.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj Prishtinë PP.II.nr.2731/23 të datës 23.05.2023, e ka akuzuar të pandehurit A. K. dhe S. K. që të dy nga fsh. M. K. L., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Palët pra, të pandehurit dhe i dëmtuari kanë propozuar që kjo çështje të dërgohet në procedurën e ndërmjetësimit dhe gjykata me dt.08.03.2024 e ka referuar rastin në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datën 21.03.2024, në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të pandehurve A. K. dhe S. K. dhe të dëmtuarit A. K., në prani të zyrtares së ndërmjetësimit të autorizuar nga institucioni i ndërmjetësimit ndërmjetsueses Mevlyde Beka.

Në seancën e ndërmjetësimit palët kanë arritur marrëveshjen me vullnetin e tyre të plotë dhe nuk kontestojnë asnjërën nga pikat e lartshënuara për të cilat pajtohen njëzëri.

Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan, me datën 25.03.2024, ka pranuar marrëveshjen e palëve me numër Nd.nr..../24, të nënshkruar me të datën 21.03.2024, për zgjidhjen e ndërmjetësimit.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 229 par.5 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2023:132375
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05531264

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN
P.nr.305/23, të datës 02.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Gentiana Dakaj

Gjyqtari
Avdirrahman Gashi

UDHEZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.